



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:193980

Datë: 22.01.2024

Numri i dokumentit: 05223348

KPPP.nr.1013/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbaremore të kreditorit “ProCredit Bank”, me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Clinton” p.n, kundër debitorëve “BESIANI” NTP me NRB80034989, me seli në fshatin Rogoçicë, Kamenicë, M.K. nga fshati Rogoçicë, Kamenicë dhe B.K. nga fshati Rogoçicë, Kamenicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.367/21 të datës 28.07.2021, të Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 16.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve “BESIANI” NTP me NRB80034989, M.K. dhe B.K. nga fshati Rogoçicë, Kamenicë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.367/21 të datës 28.07.2021, të Përmbaremit Privat Sefer SH. Arifi, me seli në Gjilan.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.367/21 i datës 28.07.2021, i Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan.

A r s y e t i m

Zyra Përmbaremore e Përmbaremit Privat Sefer Sh. Arifi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbaremore me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të Kontratës së kredisë për biznes me numër 50058582 të datës 24.02.2015, Kontratës së kredisë për biznes me numër 50059681 e datës 13.11.2015 si dhe Kontratën e Pengut me numër 50058582 dhe me numër 50059681, duke obliguar të gjitha Institucionet Financiare (Bankat), dhe në rast se ka mjete të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbaremit, shuma e borxhit prej 32,546.10 euro si dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremit. I sekuestrohet kolaterali i debitorit i cili përbëhet nga sendet të cilat janë të specifikuara në listën e pengut-Aneksi i kontratës së pengut dhe të njëjtat t'i dorëzohen kreditorit (huadhënësit) për ti shitur dhe

nga çmimi i shitblerjes të përmbushte obligimi i debitorit në shumë prej 32,546.10 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër urdhrit përbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim kanë ushtruar debitorët e përbarimit, e kanë kontestuar si të pa bazuar urdhrin përbarimor, ndër të tjerash kanë thekuar se me përfaqësuesin e kreditorit kanë arritur marrëveshje duke ja ofruar të gjitha dokumentet e veturave, kamionëve, vlerën e stoqeve dhe vlerën e prodhimeve të gatshme me qëllim që ato të llogariten dhe me këtë kemi arritur që të bëhet rikonstruimi i borxhit me një shumë të përballueshme për debitorët dhe me këtë ta paguajnë borxhin në tërësi dhe pas dorëzimit të këtyre kemi pritur që të arrijmë marrëveshje por deri më sot nuk na është paraqitur. Ka shtuar se lidhur me këtë çështje është vendosur me aktvendimin PPP.nr.56/2019 të datës 28.08.2019. Më tutje ka theksuar se janë të interesuar që këtë borxh ta rregullojnë përmes marrëveshjes gojore dhe me shkrim e të cilën e kemi patur që nga fillimi. I kanë propozuar gjykatës që prapësimi i debitorëve të aprovohet, të shfuqizohet urdhri përbarimor si dhe të obligohet kreditori t'ia kompensoj shpenzimet përbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se me vendimin PPP.nr.56/2019 të datës 28.08.2019 është refuzuar propozimi për përbarim me arsyetimin se kontratat në bazë të cilave është lejuar përbarimi kanë qenë kopje, prandaj kreditori ka parashtruar propozim të ri të cilit ia ka bashkangjitur të gjitha shkresat e lëndës kopje të vërtetuara te noteri. Tutje ka theksuar se debitori ka mundur që në çdo kohë të bëjë pagesa në llogarinë e tij bankare mirëpo nuk e ka bërë asnjë pagesë për më shumë se 3 vite dhe se kreditori është gjithmonë në gatishmëri për arritje të ndonjë marrëveshje eventuale mirëpo të dy palët duhet të jenë dakord për kushtet e marrëveshjes. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbarruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se dokument përmbarrues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në dokumentet përmbarruese përkatësisht Kontrata e kredisë për biznes me numër 50058582 të datës 24.02.2015, Kontratës së kredisë për biznes me numër 50059681 e datës 13.11.2015, Kontratat e Pengut me numër 50058582 e datës 24.02.2015, Kontrata e pengut me numër 50059681 e datës 13.11.2015, Konfirmimi i Regjistrimit të pengut me numër R-20210713-471 dhe Konfirmimi i Regjistrimit të pengut me numër R-20210713-489, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenit nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, për tu paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase Kontratat e Pengut me numër 50058582 e datës 24.02.2015, është e regjistruar në regjistrat e pengut sipas Konfirmimit të Regjistrimit R-202107136-471 dhe Kontrata e pengut me numër 50059681 e datës 13.11.2015, është e regjistruar në regjistrat e pengut sipas Konfirmimit të Regjistrimit R-20210713-489.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarrimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet

urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1013/2022, datë 16.01.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.